



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2022

V E N D I M

Nr. 47, datë 07/03/2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 177, datë 04.10.2021, së z. M.Sh., përfaqësuar nga z. G.S., Drejtor Ekzekutiv i Shoqatës “Drejtësi Sociale”, ku pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, nga ana e Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të dhënë në ankesë, z. M.Sh. është aksidentuar gjatë punës, në tetor të vitit 2015. Si pasojë e këtij aksidenti, ankuesi ka humbur këmbën e djathtë, duke humbur gjithashtu edhe aftësinë për të punuar. Për shkak të mungesës së viteve minimale të sigurimit, mbështetur në nenin 37/1, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore”, i ndryshuar, ai trajtohet me pension invaliditeti të reduktuar, i cili nuk i mjafton për të plotësuar nevojat bazike për jetesë.

Për këtë arsye, në referencë të nenit 20 “Punësimi i personave të grupeve të veçanta”, të ligjit nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, ankuesi është paraqitur në muajin tetor 2019 pranë Zyrës së Punësimit, për të siguruar punë të përshtatshme për kushtet dhe aftësitë e tij. Ankuesi

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD;

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD;

pretendon se nga ana e përfaqësuesve të kësaj zyre nuk i është gjetur mundësia për punësim. Në këtë kontekst, ai pretendon se diskriminohet për shkak të aftësisë së tij të kufizuar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të hetuar dhe shqyrtuar ankesat e depozituara nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 5, i Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ndalon diskriminimin për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrjen në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë. Ndërsa, në Kreun III, të ligjit parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pikën 1 të tij parashikon se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”*

Sipas nenit 7, të LMD-së, i ndryshuar, çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash,

përbën diskriminim. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

Hapat proceduriale të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 177, datë 04.10.2021 u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, me shkresën nr. 1380/1, datë 06.10.2021, ku kërkohet informacion, si më poshtë vijon:
 1. Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesit;
 2. Informacion nëse ankuesi është regjistruar si punëkërkues i papunë. Nëse po, lutemi të dërgohet një kopje e kartelës përkatëse;
 3. Informacion nëse institucioni juaj ka kryer përpjekje për gjetje punësimi të përshtatshëm për z. M.Sh. Nëse po, lutem të evidentohen mundësitë e punësimit të gjetura dhe të propozuara ndaj tij;
 4. Informacion mbi numrin e individëve me aftësi të kufizuar, që janë të regjistruar si punëkërkues të papunë;
 5. Informacion mbi numrin e individëve me aftësi të kufizuara, punëkërkues të papunë, të cilët janë sistemuar në punë të përshtatshme për ta, përgjatë dy viteve të fundit;
- Në përgjigje të shkresës nr. 1380/1, datë 06.10.2021, së KMD-së, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dërgoi shkresën nr. 3498/2, datë 18.10.2021, ku sqaron se Drejtoria e Përgjithshme e Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, pasi ka kryer verifikimet përkatëse në sistemin elektronik të zyrës së ofrimit të shërbimeve të

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “*Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër*”.

punësimi, pranë së cilës ankuesi ka marrë shërbime, i ka kërkuar Drejtorisë Rajonale të AKPA-s Elbasan informacion lidhur me rastin e tij.

Kjo zyrë ofron shërbime edhe për personat me aftësi të kufizuara, si kategori e veçantë e punëkërkesve të papunë. Nga të dhënat në nivel kombëtar, deri në muajin prill 2021 rezultojnë 697 persona me aftësi të kufizuar të regjistruar si punëkërkes të papunë në strukturat vendore të punësimi. Gjatë periudhës janar 2019-gusht 2021, të dhënat mbi shërbimet që i janë ofruar individëve të kësaj kategorie janë:

- 152 persona të punësuar (me ndërmjetësim ose kanë gjetur punë vetë, pasi janë trajtuar dhe kanë marrë shërbime nga zyrat e punës);
- 218 persona kanë përfituar falas një kurs formimi profesional;
- 80 persona janë mbështetur me programe të nxitjes së punësimi, si dhe kanë marrë shërbime të tjera informimi apo këshillimi.

Bashkëlidhur shkresës së këtij institucioni është dërguar shkresa nr. 994/1, datë 11.10.2021, e Drejtorisë Rajonale të AKPA-s Elbasan, ku jepet informacion mbi ankuesin M.Sh.. Sipas këtij informacioni rezulton se ankuesi ka qenë i regjistruar për herë të fundit pranë DRSHKP Elbasan (i ndryshuar në DRAKPA⁴ Elbasan) deri në datën 17.08.2017 dhe nuk është paraqitur më pranë këtij institucioni. Për këtë arsye regjistrimi i tij është çaktivizuar sipas legjislacionin në fuqi. Kështu, sipas të dhënave të DRSHKP Elbasan pretendimi i ankuesit se është paraqitur në vitin 2019 dhe nuk i është ofruar punë, bie poshtë. Sipas shkresës së këtij institucioni, në ankesën e z. M.Sh. pretendohet se është me aftësi të kufizuar, ndërkohë që në sistemin elektronik të DRAKPA Elbasan nuk rezulton të ketë ndonjë problem fizik apo shëndetësor, sipas vetëdeklarimit të bërë duke iu përgjigjur pyetjeve të zhvilluara nga specialisti i zyrës, në bazë të formularit të sistemit elektronik të AKPA-s. Z. M.Sh. është riparaqitur pranë zyrës vendore të punësimi dhe është regjistruar në datën 03.03.2021, ku është intervistuar nga specialisti i shërbimeve. Ky i fundit, pasi e ka këshilluar dhe orientuar të kryejë një kurs formimi profesional, i ka ofruar një vend pune pranë subjektit Citytex, në qytetin e Elbasanit. Ankuesi e ka refuzuar këtë vend pune duke deklaruar se punon në qytete të ndryshme. Specialisti i zyrës referon se ankuesi nuk ka arsim dhe një profesion. Për këtë arsye i është sugjeruar që të marrë një profesion pasi e ndihmon atë të përshtatet me tregun e punës. Z. M.Sh. ka refuzuar të ndjekë një kurs profesional, sepse është i interesuar për ndihmën ekonomike dhe për të marrë shërbimet shëndetësore falas.

Përveç sa më sipër, Drejtorja Rajonale e AKPA-s, Elbasan informon se në këtë qytet janë regjistruar rreth 150 punëkërkes me aftësi të kufizuar. Brenda dy viteve të fundit janë punësuar 3 individë PAK, ku njëri prej tyre është punësuar nëpërmjet programit të nxitjes së

⁴ Akronim i emërtesës Drejtorja Rajonale e Agjencisë Kombëtare të Punësimi dhe Aftësive, Elbasan.

punësimit. Njëkohësisht, ky institucion sqaron se 78 individë PAK, që janë të regjistruar si punëkërkes të papunë, janë drejtuar për të kryer kurse të formimit profesional.

Bashkëlidhur shkresës së sipërcituar janë dërguar printime të kryera nga Sistemit Elektronik të Punësimit, që kanë lidhje me ankuesin.

- Në vijim, në datën 20.10.2021, KMD i dërgoi me e-mail përfaqësuesit të ankuesit, kopje të shkresave të sipërcituara, duke i theksuar faktin se nëse disponohet informacion i mëtejshëm mbi çështjen, të dërgohej me e-mail në adresë të KMD-së.
- Përfaqësuesi i ankuesit iu drejtua, me e-mail KMD-së, në datën 21.10.2021, ku citohet: *“Në lidhje me përgjigjen e Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, mendoj se numri 80 i të punësuarve nëpermjet programit të nxitjes së punësimit, më duket jo real ndaj do ishte mirë të tregohej më shumë në këtë drejtim. Përsa i përket rastit të z. M. Sh., shprehim se është i gatshëm të punësohet nëse ofrohet vend pune. Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive të tregojë konkretisht aftësitë e saj për të punësuar individë me aftësi të kufizuara, duke ditur që familja e tij ka si të ardhur vetëm 2800 lekët që merr nga pensioni.”* Në vijim, z. G.S. kërkoi nga KMD, që të zhvillohej një seancë dëgjimore.
- Mbështetur në kërkesën e përfaqësuesit ligjor të ankuesit, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u realizua në datën 15.12.2021, ora 11:00, pranë Zyrës së KMD-së.

Në këtë seancë dëgjimore mori pjesë përfaqësuesi ligjor i ankuesit, z. G.S. dhe përfaqësuesit e Drejtorisë Rajonale të Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Elbasan, përfaqësuar nga znj. M.H. drejtore e këtij institucioni, z. K.K., përgjegjës zyre dhe znj. K.D., specialiste shërbimi.

Përfaqësuesi ligjor i ankuesit parashtroi edhe një herë pretendimet e tij para përfaqësuesve të KMD-së, duke theksuar faktin se z. M.Sh. ka pësuar një aksident në punë dhe është një person me aftësi të kufizuara. Ankuesi është banor i qytetit të Tiranës dhe është paraqitur disa herë pranë Zyrave të Punës për të gjetur një punë të përshtatshme për të. Z. G.S. u shpreh se në dijeninë e tij, vitet e fundit nuk ka patur punësime të grupeve të tilla vulnerabël, si dhe shprehu gatishmërinë të pranojë ndërmjetësimin e KMD-së me subjektin respektiv, me qëllim që ankuesit të punësohet sa më parë.

Përfaqësuesit e KMD-së sqaruan se KMD i ka kërkuar informacion subjektit kundër së cilit drejtohej ankesa nëpërmjet shkresës nr. 1380/1 prot., datë 06.10.2021 dhe në përgjigje të kësaj shkresë AKPA ka dërguar shkresën nr. 3498/2, datë 18.10.2021, duke sqaruar se Drejtoria e Përgjithshme ka kryer verifikimet përkatëse lidhur me rastin e z. M.Sh. dhe bashkëlidhur ka përcjellë shkresën nr. 994/1, datë 11.10.2021 të Drejtorisë Rajonale të AKPA-s Elbasan.

Ndërkohë që, Drejtoresha e Drejtorisë Rajonale Elbasan të AKPA-s sqaroi se ankuesi M.Sh. nuk rezultoi i regjistruar në sistem në vitin 2019. Dikur, ai ka figuruar i regjistruar, por nuk rezultoi me aftësi të kufizuara. Ajo theksoi se z. M.Sh. është i datëlindjes 22.05.1991 dhe kërkoi konfirmim nga përfaqësuesi ligjor i ankuesit nëse bëhej fjalë për të njëjtin person.

Përfaqësuesit e KMD-së vunë në dukje faktin se përfaqësuesi ligjor i tij kishte marrë dijeni mbi shkresën e sipërcituar, pasi i ishte dërguar nëpërmjet emailit zyrtar. Njëkohësisht, shkresa e AKPA-s është dërguar për dijeni edhe në adresë të përfaqësuesit ligjor të ankuesit, i cili e mohoi ta kishte marrë këtë shkresë.

Përfaqësuesit e KMD-së vunë në dukje faktin se pasi ka kryer verifikimet përkatëse, AKPA e ka deleguar rastin konkret pranë Drejtorisë Rajonale Elbasan, ku z. M.Sh. rezultoi i regjistruar. Nga verifikimet e AKPA-s, z. M.Sh. nuk rezultoi i regjistruar në Tiranë.

Z. G.S. u shpreh se ankuesi është paraqitur disa herë fizikisht për të kërkuar punë pranë zyrave respektive, por ndodh që të mos jetë pjesë e sistemit, duke ditur se ai përfiton pension invaliditeti dhe rezultoi në listat e sigurimeve shoqërore.

Përfaqësuesja e Drejtorisë Rajonale Elbasan të AKPA-s u shpreh se që prej vitit 2020, regjistrimi si punëkërkues i papunë bëhet i mundur nëpërmjet aplikimit *on line* në e-Albania.

Përfaqësuesi ligjor i ankuesit sqaroi se ankesa bën fjalë për një periudhë kohore të mëparshme, që i takon vitit 2019, kohë kjo kur regjistrimi kryhej, kur individi paraqitej fizikisht pranë zyrave respektive të punës.

Për sa më sipër, palët ranë dakord që shkresa përgjigje e dërguar nga AKPA, bënte fjalë për një person tjetër, që mbante të njëjtin emër me ankuesin dhe që ishte banor në qytetin e Elbasanit. Nga verifikimet e kryera ka rezultuar se personi me këtë emër ka aplikuar vetëm pranë Drejtorisë Rajonale Elbasan të AKPA-s.

Z. G.S. u shpreh se do ta asistonte ankuesin për të aplikuar, duke shpresuar që të mos e humbte pagesën që merr për aftësinë e tij të kufizuar.

- Në vijim të seancës dëgjimore, KMD iu drejtua AKPA-s me anë të shkresës nr. 1380/4, datë 17.12.2021, nëpërmjet së cilës kërkohet të kryhen edhe një herë verifikimet përkatëse, nëse ankuesi M.Sh. ka qenë i regjistruar në muajin tetor 2019, sikurse edhe aktualisht, në sistemin elektronik të këtij institucioni, si punëkërkues i papunë, duke u mbështetur në të dhënat e tij personale, sipas kopjes së kartës së identitetit që iu dërgua bashkëlidhur shkresës.
- Në përgjigje të shkresës nr. 1380/4, datë 17.12.2021, së KMD-së, AKPA dërgoi shkresën nr. 3498/5 prot., datë 21.12.2022, ku sqarohet se pas verifikimeve të kryera

rezulton se z. M.Sh., i pajisur me dokumentin e identifikimit nr. personal H901120421, nuk rezulton të jetë i regjistruar si punëkërkues në sistemin e Shërbimeve të Punësimit.

I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

Ligji ligjit nr. 15/2019 *“Për nxitjen e punësimit”* përcakton rregullat dhe mënyrën e funksionimit të sistemit publik të shërbimeve të punësimit, të programeve aktive e pasive të tregut të punës, si dhe organet përgjegjëse për menaxhimin e tyre. Ky ligj ka për qëllim rritjen e punësueshmërisë së forcave të punës, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve dhe programeve publike të punësimit, të vetëpunësimit dhe të kualifikimit profesional⁵.

Në kuptim të nenit 3 të këtij ligji, *“Aftësimi dhe rehabilitimi për punë për personat me aftësi të kufizuara”* konsiston në shërbimet mbështetëse dhe dhënien e asistencës për vlerësimin e aftësisë për punë të personit me aftësi të kufizuara, të cilat ofrohen nëpërmjet: a) informimit, këshillimit profesional, vlerësimit të aftësive profesionale dhe gjetjes së punës; b) vlerësimit të mundësisë për aftësim, dhe hartimit të programeve përkatëse; c) aftësimit profesional, kualifikimit plotësues, rikualifikimit me programet e mbajtjes dhe përmirësimit të aftësive të punës deri në momentin e punësimit.

Sipas pikës 13 të nenit të sipërcituar, *“punëkërkues”* është çdo person me vendbanim në Republikën e Shqipërisë, në moshë pune, që regjistrohet si kërkues pune në strukturën rajonale/vendore dhe është i gatshëm për punë.

Pikërisht vetëm pas kryerjes së këtij regjistrimi, strukturës përgjegjëse i lind detyrimi ligjor për t'i siguruar punë personit të regjistruar, fakt që është i parashikuar në nenin 4, pika 1 të ligjit nr. 15/2019 *“Për nxitjen e punësimit”*, ku përcaktohet se: *“Çdo punëkërkues dhe punëdhënës i regjistruar në strukturën rajonale/vendore përfiton nga shërbimet që ofrohen nga kjo strukturë.”*

Mbështetur në dokumentacionin e depozituar në cilësi prove, rezulton se z. M.Sh. është aksidentuar gjatë punës, në tetor të vitit 2015 dhe si pasojë e këtij aksidenti, ankuesi ka humbur këmbën e djathtë, duke humbur gjithashtu edhe aftësinë për të punuar. Për shkak të

⁵ Referuar neneve 1-2 të ligjit nr. 15/2019 *“Për nxitjen e punësimit”*.

mungesës së viteve minimale të sigurimit, mbështetur në nenin 37/1, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore”, i ndryshuar, ai trajtohet me pension invaliditeti të reduktuar, i cili nuk i mjafton për të plotësuar nevojat bazike për jetesë.

Në nenin 20/1 “Punësimi i personave të grupeve të veçanta”, të ligjit nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, parashikohet shprehimisht se: “Çdo punëdhënës duhet të punësojë: a) një person që i përket grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji, për 25 punonjësit e parë të ndërmarrjes”. Neni 3, pika 4, shkronja c) i këtij ligji përcakton se: “Grupe të veçanta” janë punëkërkuar të disavantazuar në tregun e punës, si: c) persona me aftësi të kufizuara, përfshirë personat që nuk dëgjojnë dhe invalidët e punës të vlerësuar pjesërisht të aftë për punë nga komisionet përkatëse”.

Mbështetur në parashikimet e sipërcituara, ankuesi pretendon se është paraqitur në muajin tetor 2019 pranë Zyrës së Punësimit, Tiranë, për të siguruar një punë të përshtatshme për kushtet dhe aftësitë e tij. Ankuesi pretendon se nga ana e përfaqësuesve të kësaj zyre nuk i është gjetur mundësia për punësim dhe në këto kushte ai pretendon se diskriminohet për shkak të aftësisë së tij të kufizuar.

Gjatë hetimit administrativ të ankesës, Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive e ka informuar Komisionerin me shkresën nr.3498/2, datë 18.10.2021, ku ka sqaruar faktin se pasi janë kryer verifikimet përkatëse në sistemin elektronik të zyrës së ofrimit të shërbimeve të punësimit, pranë së cilës ankuesi M.Sh. ka marrë shërbime, i është kërkuar Drejtorisë Rajonale të AKPA-s Elbasan informacion lidhur me rastin e ankuesit. Bashkëlidhur shkresës së sipërcituar në adresë të KMD-së është dërguar edhe shkresa nr. 994/1, datë 11.10.2021, e Drejtorisë Rajonale Elbasan të AKPA-s, ku jepet informacion mbi ankuesin M.Sh.. Në këtë shkresë theksohet fakti se ankuesi nuk është me aftësi të kufizuara.

Për sa më sipër, përfaqësuesi ligjor i ankuesit M.Sh. u bë me dije lidhur me përgjigjen zyrtare të AKPA-s, ndërkohë që edhe vetë shkresa e këtij institucioni i është dërguar për dijeni, duke mos e kundërshtuar një fakt të tillë.

Në seancën dëgjimore të datës 15.12.2021, të zhvilluar pranë KMD-së, ku mori pjesë përfaqësuesi ligjor i ankuesit dhe përfaqësues nga Drejtoria Rajonale Elbasan e AKPA-s, rezultoi se informacioni i dërguar nga ky institucion i përkiste një tjetër personi, banues në qytetin e Elbasanit, por që kishte emër dhe mbiemër të njëjtë me ankuesin M.Sh., i cili banon në Tiranë. Nga verifikimet e mëtejshme të kryer nga AKPA, mbështetur në të dhëna më të specifikuar të z. M.Sh., rezultoi se ankuesi nuk ka qenë asnjëherë i regjistruar në vitin 2019 në regjistrin elektronik të punësimit që administrohet nga ky institucion. Njëkohësisht, AKPA e bën me dije KMD-në se ankuesi nuk rezulton i regjistruar edhe aktualisht në këtë regjistër.

Në këtë kontekst, KMD gjykon se në kushtet kur, ankuesi M.Sh. nuk rezulton i regjistruar, në vitin 2019, në regjistrin elektronik të punësimit, sipas dispozitave përkatëse ligjore, nuk mund të pretendojë se është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga ana e Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, e cila ka detyrim ligjor të sigurojë punësim vetëm për ata persona që janë të regjistruar pranë strukturave përgjegjëse.

Duke mos ekzistuar një trajtim i tillë, ankuesi M.Sh. nuk diskriminohet për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pikat 1 dhe 3, nenit 20, nenit 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-12, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të z. M.Sh., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga marrja dijëni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkak – aftësia e kufizuar
Fusha – Të mira dhe Shërbime
Lloji i vendimit - mosdiskriminim